

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DHËNIE AMNISTIE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është hartuar me qëllim trajtimin njerëzor dhe respektimin e dinjitetit të individit, riintegrimin dhe rehabilitimin social.

Një ndër parimet e legjislacionit penal të sanksionuar në Kodin Penal është parimi i humanizmit. Duke parë në mënyrë të ndërthurur të gjitha institutet e ligjit penal, për vepra të lehta penale, për të miturit dhe për autorët femra vlerësohet se dhënia e dënimit nga gjykata apo kryerja e dënimit e arrin qëllimin e vet edhe pa qenë nevoja për ekzekutimin e plotë të tij.

Gjithashtu, duke pasur si qëllim, ndër të tjera, ndryshimet pozitive në jetën e të dënuarve, si dhe trajtimin e tyre sipas standardeve evropiane në sistemin penitenciar, në rastet kur dënimi është pothuajse i përfunduar, vlerësohet se përfundimi i dënimit nuk shkon më as në favor të të dënuarit, as në favor të institucioneve penale dhe as në favor të viktimës.

Po kështu, për rastet e veprave tepër të lehta penale vlerësohet se është më e përshtatshme të shuhet ndjekja penale, procedimi penal apo gjykimi pasi rrezikshmëria e veprës penale dhe rrezikshmëria e autorit nuk diktojnë nevojën për të aplikuar dënime me burgim apo dënime të tjera më të lehta. Kjo në kuadër të parimit të humanizmit për t’iu dhënë mundësi personave të integrohen në liri dhe pa iu nënshtruar dënimit penal, por edhe në kuadër të barazisë përpara ligjit, në kushtet kur të njëjtat vepra amnistohen nga dënimi.

Në këtë kuadër, qëllimi i nismës konsiston në amnistinë e dënimit, e cila ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar tërësisht ose pjesërisht ekzekutimin e tij, si dhe amnistinë e ndjekjes penale, procedimit penal dhe gjykimit penal vetëm për ato vepra dhe në ato raste kur ligji nuk e ndalon.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të aplikohet një politikë lehtësuese penale për t’iu dhënë mundësi personave të dënuar të vijojnë me rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri, duke vlerësuar se qëllimi i dënimit penal është arritur.

Gjithashtu, nëpërmjet kësaj nisme krijohen lehtësi në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duke ndihmuar në uljen e numrit të popullimit në këto

institucione. Ndodhur në kushtet e mbipopullimit në burgje, aktualisht, kjo masë do të ndihmonte në uljen e numrit të personave të dënuar që qëndrojnë në këto ambiente dhe do t'i jepte mundësi institucionit të përdorë të gjitha kapacitetet për të dënuarit e tjerë për vepra penale më të rënda.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt vjen si propozim i Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2026 për Ministrinë e Drejtësisë.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj është hartuar me qëllim trajtimin njerëzor, respektimin e dinjitetit, riintegrimin dhe rehabilitimin social të personave të dënuar dhe të atyre që janë duke u ndjekur penalisht për vepra penale të lehta.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 71: *“Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe.”*

Aplikimi i amnistisë vlerësohet edhe në raport me sistemin e dënimeve, në thelb të të cilit funksionon parimi se sanksionet penale si *“ultima ratio”*, duhet të udhëhiqen nga parimet kushtetuese dhe funksionet që i karakterizojnë ato, përkatësisht ai edukativ (funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale) dhe ai i parandalimit të posaçëm (që lidhet me riedukimin e autorit të veprës penale).

Ky projektligj është hartuar sipas parimeve të humanizmit, të sanksionuara në Kodin Penal. Në Republikën e Shqipërisë, amnistia është zbatuar si një politikë penale lehtësuese ndër vite për vepra penale të lehta, në kuadër të rehabilitimit social të personave që kanë kryer vepra penale si dhe në kuadër të optimizimit të kapaciteteve në burgje.

Ky projektligj është rezultat i një analize shumë të kujdesshme të bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ligji i fundit mbi amnistinë është bërë në vitin 2024. Janë studiuar dhe analizuar të gjitha të dhënat statistikore të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga ku ka rezultuar

se ka mjaft të dënuar për vepra penale të lehta të cilët vuajnë dënim me burgim, apo kanë kryer pjesën dërrmuese të masës së dënimit.

Gjatë hartimit të projektligjit është pasur në vëmendje që kategoritë e veprave penale që parashikojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore ose të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të theksuar, të përjashtohen nga kjo amnisti, si konkretisht veprat penale kundër personit, si vrasja, plagosja, dhuna në familje, veprat penale kundër mjedisit, terrorizmit, korrupsioni etj.

Konkretisht, nga kjo amnisti përfitojnë:

1. Të dënuarit burra me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet dhe personat burra të dënuar me mbi 3 vjet, por që u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim një periudhë deri në 3 vjet.
2. Të dënuara gra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet, dhe grave që janë dënuar me vendim të formës së prerë mbi 4 vjet, që u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim një periudhë deri në 4 vjet.
3. Personat e dënuar gra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baraz ose mbi moshën 50 vjeç.
4. Personat e dënuar burra, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baraz ose mbi moshën 60 vjeç.
5. Personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baraz ose nën moshën 18 vjeç.

Edhe nëse një person i dënuar përfiton nga kriteret e përmendura lart, nuk përfiton nga amnistia nëse veprat penale që ka kryer janë parashikuar si kritere ndaluese në këtë projektligj.

Gjithsesi, kemi vlerësuar që të gjithë të dënuarit të përfitojnë nga kjo amnisti, duke parashikuar zbritje të dënimit, përkatësisht për personat e dënuar të mitur dhe gra 1 vit e gjysmë ulje të dënimit, si dhe 1 vit për personat e dënuar burra.

Lidhur me rastet e ndjekjes penale për vepra penale të lehta, të parashikuara me dënim maksimumi deri në 3 vjet, të cilat përfshihen në këtë amnisti, kemi vlerësuar se është e përshtatshme të shuhet ndjekja penale, procedimi penal apo gjykimi.

Afati i shtrirjes së amnistisë për shuarjen e dënimit dhe shuarjen e ndjekjes penale është data 31.12.2025.

Kjo nismë ka në vëmendje të veçantë gratë dhe të miturit, duke i dhënë një tjetër dimension qasjes rehabilituese drejt riintegrit të shpejtë të kategorive më vulnerabël të të dënuarve.

Amnistia shtrihet vetëm për vepra penale të lehta, pasi, bazuar në analizën e legjislacionit dhe faktorët kriminogjenë, janë identifikuar veprat penale për të

cilat kurrsesi nuk mund të shuhet dënimi apo ndjekja penale. Projektligji përjashton nga fusha e tij e zbatimit kategoritë e veprave penale që parashikojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore ose të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të theksuar, të cilat në grupime të përgjithshme veprash penale, janë veprat penale të listuara në ligj lidhur me:

- krimet kundër njerëzimit;
- krimet e rënda kundër jetës;
- veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit;
- krimet seksuale;
- veprat penale kundër lirisë së personit;
- veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit;
- veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes;
- vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve;
- veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve;
- vepra penale kundër mjedisit;
- krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera;
- vepra me qëllime terroriste;
- krime kundër autoritetit të shtetit;
- vepra penale kundër drejtësisë;
- vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale.

Po ashtu, nuk përfitojnë nga amnistia personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b, 79/c, të Kodit Penal, personat e dënuar me burgim të përjetshëm dhe personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a. Gjithashtu, përjashtohen nga amnistia personat që i janë shmangur drejtësisë.

Ndërkohë, sipas parashikimeve të përmendura më lart të këtij projektligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e fshehur, të arratisur ose të ikur, të cilët, megjithëse kanë dijeni, i shmangen me vullnet procedimit penal, zbatimit të masave të sigurimit ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit. Ky parashikim është bërë për shkak se qëllimi i amnistisë është rehabilitimi i personave dhe personat që i shmangen drejtësisë nuk mund të përfitojnë nga kjo masë e cila në thelb ka humanizmin dhe riintegrimin, pasi me

veprimet e tyre kanë treguar se nuk janë në kushtet e rehabilitimit dhe nuk synojnë pikërisht këtë riintegrim.

Rehabilitimi dhe riintegrimi në shoqëri i personave që kanë kryer vepra penale

Nëpërmjet instrumentit të amnistisë u jepet mundësia personave që kanë kryer vepra penale të riintegrohen në shoqëri në liri, duke shmangur aplikimin e masave represive. Bazuar në standardet ndërkombëtare është vlerësuar se kufizimi i lirisë dhe zbatimi i dënimeve penale ndëshkuese duhet parë si masë e fundit, e cila duhet të jetë në proporcion me shkeljen e kryer dhe rrezikshmërinë e personit.

Në rastet e veprave penale të lehta konsiderohet se dënimi me burgim mund të shmanget bazuar në parimin e humanizmit, duke i krijuar personit rrethanat të provojë në liri se është rehabilituar/korrigjuar dhe do të parandalohet kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Amnistia bëhet duke pasur veçanërisht në konsideratë nevojat që lidhen me kushtet personale, familjare, sociale, të të dënuarave gra, të të miturve dhe subjekteve që, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë të mitur, në tërësi, moshën, arsimimin apo nevoja të tjera të të miturit, në veçanti. Në këto kushte, aplikimi i amnistisë, përveçse ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve në institucionet penitenciare, pavarësisht se kjo nuk është nxitja kryesore e ndërmarrjes së kësaj nisme, është një akt i cili shpreh vullnetin shtetëror për të rivendosur dinjitetin e të dënuarve, duke iu dhënë atyre mundësinë dhe mirëbesimin të rindërtojnë të ardhmen vetjake, duke mbajtur në konsideratë se qëllimi i ligjit penal është arritur.

Konkretisht, në kuadër të arritjes së qëllimit të synuar, në drejtim të minimizimit të pengesave ligjore ndaj kategorisë së të dënuarve të mitur dhe të dënuarave gra, si dhe duke pasur në konsideratë kushtet psiko-sociale veçanërisht të dallueshme të kësaj kategorie, në raport me të dënuarit e tjerë, nëpërmjet projektligjit parashikohen rregulla të posaçme mbi amnistimin nga dënimi për këtë kategori, duke i dhënë lehtësi dhe përparësi në raport me të dënuarit meshkuj. Përcaktimi i kriterëve lehtësues për përfitimin nga amnistia, për të miturit dhe gratë, bëhet jo vetëm nisur nga qëllimet e humanizmit dhe të ofrimit të mbështetjes më të lartë për këtë kategori, por edhe për shkak të pozitës më vulnerabël në shoqëri, pavarësisht se janë ndëshkuar si autorë të veprës penale.

Për këtë arsye, politikat e përgjithshme shtetërore i kanë dhënë përparësi të miturve dhe grave jo vetëm lidhur me drejtësinë penale por edhe në fusha të tjera, duke u dhënë një mundësi më shumë për një riintegrim më të shpejtë. Tashmë është e qartë se gratë dhe të miturit duhet të kenë në shoqërinë tonë një përfaqëse më specifike, përfshirë përfaqësen e diferencuar sa i përket përfitimit nga amnistia, ashtu si një përfaqëse ndryshe në përcaktimin e masës së dënimit, si dhe dhënien e

mundësive specifike mbështetëse për të vijuar jetën e tyre në shoqëri. Të miturit dhe gratë, në përgjithësi, bazuar në fenomenet shoqërore dhe stadin e zhvillimit të vendit, në momentin e lirit, përballen me vështirësitë e rikthimit në komunitet për shkak të problematikave që hasin në akomodim, punësim, nxjerrje të ardhurash dhe përkujdesje ndaj fëmijëve e familjarëve të tyre.

Në këtë kuadër, duke iu dhënë mundësi personave të rikthehen në shoqëri si qytetarë të lirë, të kenë mundësi të integrohen pranë familjeve të tyre dhe jo pranë institucioneve shtetërore, të rifillojnë integrimin e tyre në tregun e punës dhe të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre si qytetarë, shteti iu jep një shans të dytë për të besuar në funksionimin e sistemit dhe shtetin e së drejtës.

Lehtësitë në sistemin penitenciar

Nëpërmjet zbatimit të amnistisë, një nga efektet kryesore është edhe ulja e numrit të të dënuarve në institucionet penitenciare. Ulja e numrit të personave të burgosur përmirëson kushtet në këto institucione, duke garantuar trajtimin e tyre në përputhje me rregullat evropiane të burgjeve.

Aktualisht, në sistemin e burgjeve janë të akomoduar gjithsej 4 982 persona, nga të cilët 1 827 të dënuar dhe 2 629 të paraburgosur (gjendja datë 24.12.2025). Janë analizuar të dhënat për personat e burgosur që ndodhen aktualisht në sistemin e burgjeve dhe, referuar kritereve të ligjit nr.33/2024, “Për dhënie amnistie”, rezulton se rreth 380 shtetas përfitojnë lirin e menjëhershëm dhe rreth 900 shtetas përfitojnë ulje dënimi, nëse zbatohen të njëjtat kritere të përcaktuara në këtë ligj.

Gjendja në sistemin e burgjeve

- Totali i personave në sistemin e burgjeve: 4 982 persona (të dënuar, të paraburgosur dhe masë mjekësore së bashku).
- Të dënuar me vendim të formës së prerë: 1 827 persona.
- Të paraburgosur: 2 629

Përfituesit e lirit të menjëhershëm

- Numri i përgjithshëm i të dënuarve që përfitojnë lirim të menjëhershëm: rreth 380 shtetas, për të cilët parashikohet përjashtimi nga vuajtja e dënimit. Nga këta, përfshihen:
 - 4 të mitur.
 - 5 femra.
 - 7 shtetas të huaj.

Përfituesit e uljes së dënimit

- Numri i përgjithshëm i të dënuarve që përfitojnë ulje dënimi: rreth 900 persona, ku parashikohen zbritje konkrete të viteve nga dënimi i mbetur.
Brenda këtij grupi:
 - 10 femra;
 - 3 të mitur.;
 - 12 shtetas të huaj.

Tabela përmbledhëse sipas kategorive

Kategoria	Totali që përfitojnë	Të mitur	Femra	Shtetas të huaj
Lirim i menjëhershëm	380 persona	4	5	7
Ulje dënimi	900 persona	3	10	12

Shifrat e mësipërme janë dinamike dhe ndryshojnë në vazhdimësi, por vlen të përmendet impakti që do të ketë në lidhje me popullimin në sistemin e burgjeve. Aktualisht, sistemi i burgjeve ka kapacitet 5 461¹ vende dhe 4 982 persona të akomoduar. Sistemi aktualisht është rreth 91,2% i zënë, pra nën kapacitet të plotë, por me hapësirë relativisht të kufizuar për manovrim. Lirimi i 380 personave e ul menjëherë zënien në rreth 84,4% të kapacitetit, duke sjellë një përfitim të dukshëm si në aspektin sasior të kapaciteteve, ashtu edhe në cilësinë e trajtimit.

Përfitimet në trajtimin e të dënuarve

- Më shumë hapësirë për person: Uljet e mbipopullimit nga 4982 në 4602.
- Përmirësim i shërbimeve dhe sigurisë: Me më pak të dënuar për të njëjtin numër personeli dhe infrastrukturë, ulet ngarkesa e punës mbi:
 - sigurinë dhe menaxhimin e konflikteve;
 - shërbimet shëndetësore dhe psikosociale;
 - pjesëmarrjen në punë, arsim dhe programe rehabilitimi, duke rritur mundësinë për trajtim më të individualizuar dhe në përputhje me standardet evropiane.

Lehtësimi i vëllimit të punës në organet e prokurorisë dhe gjykatave

Nëpërmjet shuarjes së ndjekjes penale shteti heq dorë nga hetimi apo dënimi i disa veprave penale të cilat konsiderohen se nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore dhe nuk shfaqen si fenomene shqetësuese.

¹ Nga numri i përgjithshëm zbriten 75 vende nga mbyllja e burgut të Tepelenës

Konkretisht, projektligji parashikon se pushimin e ndjekjes penale për të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31.12.2025, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikojnë një dënim me burgim në maksimum deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të një kategorie veprash penale të cilat edhe pse dënohen deri në 3 vite burgim, paraqesin një rrezikshmëri të caktuar shoqërore.

Nuk përfitojnë nga ndjekja penale as subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, si dhe subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilëve gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas përcaktimeve, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale, brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a.

Vlerësojmë se pushimi i ndjekjes penale dhe çështjeve gjyqësore në proces, për vepra penale të leha, do të ulë numrin e çështjeve në prokurori dhe gjykata dhe ngarkesën në punë. Nëpërmjet uljes së numrit të procedimeve për vepra penale të lehta, mendojmë se organet e drejtësisë do të kenë një mundësi më shumë për të trajtuar e zgjidhur në kohë të arsyeshme çështje të tjera të rënda dhe që paraqesin më tepër interes për publikun.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ky projektakt është hartuar në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “ë”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe bazohet në parashikimet e nenit 71, të Kodit Penal, ku përcaktohet se: *“Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe.”*

Referuar parashikimeve të projektligjit në fjalë, amnistia do t’i shtrijë efektet përkatëse për dënime të dhëna si dhe për vepra penale të kryera deri në datën 31.12.2025.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i përbërë nga 8 nene.

Në nenin 1 parashikohet se qëllimi i amnistisë është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të ligjit. Gjithashtu, dhënia e amnistisë udhëhiqet nga parimet e humanizmit, arritjes së qëllimit të dënimit, edukimit dhe rehabilitimit, rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen, mbrojtjes së interesit publik, si dhe dhënies së mundësisë së integritetit më lehtë dhe më shpejt të të dënuarve.

Në nenin 2 parashikohen përkufizimet e disa termave të përdorur në këtë projektligj, duke pasur në konsideratë zbatimin me korrektësi të projektligjit dhe shmangien e mundësisë së interpretimeve të ndryshme. Konkretisht, jepet përkufizimi i personit “i dënuar” dhe “Person që i është shmangur drejtësisë”.

Në nenin 3 parashikohen kriteret për përfitimin e amnistisë, sipas të cilave përfshihen subjektet, si më poshtë:

Bazuar mbi dënimin e caktuar:

- a) personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2025, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
- b) personat femra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2025, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.

Bazuar mbi dënimin e mbetur për të vuajtur:

- a) personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet.
- b) personat femra, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 4 vjet.

Bazuar mbi moshën e personave të dënuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit:

- a) personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç.
- b) personat e dënuar meshkuj, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç.

Bazuar mbi moshën në kohën e kryerjes së veprës penale:

- a) personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

Megjithatë, këto subjekte nuk përfitojnë amnisti nëse janë dënuar për ndonjë nga veprat penale të cituara në nenin 4 të projektligjit të cilat janë veprat penale ndaluese për përfitimin e amnistisë.

Në nenin 4 parashikohen kriteret e posaçme ndaluese për përfitimin e amnistisë, për secilën kategori subjektesh, ku në pikën 1 parashikohen veprat penale, për të cilat nuk lejohet amnistia për të dënuarit meshkuj dhe në pikën 2 parashikohen veprat penale, për të cilat nuk lejohet amnistia për të dënuarit e mitur dhe të dënuarat femra, si më poshtë:

Veprat penale për të cilat nuk lejohet amnistia për të dënuarit meshkuj edhe pse është caktuar deri në 3 vite burgim, ose çdo lloj dënimi tjetër më i butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, u ka mbetur pa vuajtur 3 vite burgim (ose dënime më të lehta), apo janë baras ose mbi 60 vjeç:

- a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
- b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83, 83/a, 83/b dhe 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;
- c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 93, 96 dhe 99 të Kodit Penal;
- ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;
- d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/a, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
- dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117, në nenet 119, 120, 121 dhe 121/a të Kodit Penal;

- e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, nenin 124/a, në paragrafët e dytë e të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b, 129 dhe 130/a të Kodit Penal;
- ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 134, në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në paragrafin e dytë të nenit 160, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe në nenin 181/a të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;
- f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191, 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;
- g) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët të tretë dhe të katërt të nenit 199/a dhe nenin 199/b të Kodit Penal;
- gj) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a dhe 206/b të Kodit Penal;
- h) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;
- i) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
- j) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;
- k) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 238, 243, 244, 244/a, 245, në paragrafin e dytë dhe të katërt të nenit 245/1, në paragrafin e dytë të nenit 247, në nenet 248, 248/a, 250, 252, 253, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, 270, 271, në paragrafët e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a, 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafët e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298, në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;
- l) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç,

- 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
- ll) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
- m) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.
- n) vepra penale të parashikuara në nenet 8 dhe 9, të ligjit nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar.

Veprat penale për të cilat nuk lejohet amnistia për të dënuarit që kanë kryer veprën penale nën 18 vjeç dhe për të dënuarat femra, të cilat edhe pse janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, u ka mbetur pa vuajtur deri në 4 vjet apo janë mbi 50 vjeç:

- a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
- b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81 dhe 83/b të Kodit Penal;
- c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88 dhe 89/a dhe 93 të Kodit Penal;
- ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107/a 108 dhe në paragrafin e dytë të nenit 108/a të Kodit Penal;
- d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
- dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117 dhe në nenin 121 të Kodit Penal;
- e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a dhe 128/b dhe 129 të Kodit Penal;
- ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135 e 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 139, 140, 141, 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe nenin 181/a të Kodit Penal;
- f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin

- e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191 e 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;
- g) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a, 206/b, të Kodit Penal;
 - gj) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;
 - h) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
 - i) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;
 - j) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 243, 244, 244/a, 245, 248, 248/a, 250, 253, 257, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, në paragrafin e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a e 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafin e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafin e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298 dhe në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak ;
 - k) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 319, 318, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
 - l) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
 - ll) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.
 - m) vepra penale të parashikuara në nenet 8 dhe 9, të ligjit nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar.

Në nenin 5, në kuadër të shuarjes të pjesshme të dënimit penal, në përputhje me nenin 71 të Kodit Penal, parashikohet një ulje e dënimit për personat e dënuar, të cilët nuk plotësojnë kriteret për përfitimin nga amnistia apo, në rastin kur përmbushin kriteret, por janë dënuar për një nga veprat penale të përcaktuara në nenin 4 të projektligjit. Konkretisht, përfitojnë 1 vit e gjysmë ulje të dënimit personat e dënuar të mitur dhe gra, si dhe 1 vit për personat e dënuar burra.

Kjo zbritje e dënimit nuk aplikohet për:

- a) personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të Kodit Penal;
- b) personat e dënuar me burgim të përjetshëm;
- c) personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale apo personat e dënuar për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale, brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a. Ndërkohë, projektligji parashikon gjithashtu se nuk përfitojnë nga amnistia personat e fshehur, të arratisur ose të ikur, të cilët, megjithëse kanë dijeni, i shmangen me vullnet procedimit penal, zbatimit të masave të sigurimit ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit.

Në nenin 6 parashikohet se përjashtohen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31.12.2025, për të cilat Kodi Penal dhe Kodit Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara në nenet 83/a, 83/b, 84/a, 88/b, 90, 91, 92, 96, 105, 112/1, 113, në paragrafin e parë të nenit 117, 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, 124, paragrafi i parë i nenit 124/b, 125, 127, 130/a, 131, 132, paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 134, në nenet 137, 137/a, 142, 143/a/2, 143/a/3, 143/a/4, 143/a/5, 149, 150, 156, 160, 161, 164/a, 170/c, 170/ç, 178, 179, 179/b, 180, 180/a, 181, 185, 186, 187, 188, në paragrafin e parë të nenit 191, në nenin 192, në paragrafin e parë të nenit 192/a, në paragrafin e parë të nenit 192/b, në paragrafin e parë të nenit 193, në paragrafin e parë të nenit 197, në paragrafin e parë të nenit 201, në paragrafin e parë të nenit 202/a, në nenet 204, 205, 206, 207, 223, në paragrafin e parë të nenit 224, në nenin 225, në paragrafin e parë të nenit 236, në paragrafin e parë të nenit 237, në paragrafin e parë, të dytë, të katërt dhe të pestë të nenit 238, në paragrafin e tretë të nenit 242/a, në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 244, në nenin 244/a, në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të nenit 245/1, në paragrafin e parë të nenit 251, në nenet 254, 255, 256, në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 257/a, në nenin 259, në paragrafin e dytë të nenit 261, në paragrafin e parë të nenit 263, në nenet 265/c, 269, 271, në paragrafin e parë të nenit 274/a, në paragrafin e tretë të nenit 274/b, në paragrafin e katërt të nenit 278, në paragrafin e parë të nenit 279, në nenin 287/a, në paragrafin e parë të nenit 287/b, në paragrafin e parë të nenit 288, në paragrafin e parë të nenit 288/a, në paragrafin e parë të nenit 288/c, në nenet 288/ç e 293, në paragrafin e parë të nenit 293/b, në paragrafin e parë të nenit 295, në paragrafin e dytë dhe të katërt të nenit 295/a, në nenin 296, në paragrafin e parë të nenit 300, në nenin 301, në paragrafin e dytë të nenit 306, në paragrafin e dytë të nenit 308, në paragrafin e parë të nenit 309, në paragrafin e dytë të nenit 313/b, në nenet 317 e 318, në paragrafin e dytë të nenit 320/a, në

paragrafin e parë të nenit 324/a, në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 327, në paragrafin e parë dhe të tretë të nenit 327/a, në paragrafin e parë, të dytë, të tretë, të katërt të nenit 328/a, në paragrafin e parë të nenit 329, në paragrafin e parë të nenit 330/a, në paragrafin e parë të nenit 331/a, në nenin 332, të Kodit Penal, si dhe në paragrafin e parë të nenit 21, në nenin 23, në paragrafin e dytë të nenit 38, në paragrafin e dytë të nenit 39, në paragrafin e parë të nenit 42, në paragrafin e parë të nenit 47, në paragrafin e parë të nenit 51, në paragrafin e parë të nenit 67, në paragrafin e parë të nenit 74, në paragrafin e dytë të nenit 81, në nenet 85 e 92, të Kodit Penal Ushtarak.

Nuk përfitojnë nga ky nen personat të cilët i janë shmangur drejtësisë.

Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, si dhe subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilëve gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale, brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a.

Neni 7 i projektligjit parashikon se nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Një parashikim i tillë është bërë duke pasur si qëllim ruajtjen e balancës ndërmjet të drejtave të të pandehurit nga njëra anë dhe të drejtave të viktimës nga ana tjetër.

Neni 8 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit, 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit janë Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, gjykatat dhe prokuroritë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.727, datë 22.12.2025, të ministrit të Drejtësisë.

Projektligji është bashkërenduar edhe me mendimet e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Avokatit të Popullit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE